



## AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

### Njoftim për ndarjen e *Shpërblimit mbështetës* të ASHAK-ut për vitin 2025

Komisioni për përzgjedhjen e kandidatit për *Shpërblimin mbështetës* të ASHAK-ut për vitin 2025 (në tekstin e mëtejme Komisioni) i ka shqyrtuar me kujdes të gjitha aplikacionet e kandidatëve të paraqitur, gjithsejt 16. Për secilin kandidat janë nxjerrë të dhënat prej platformës Scopus dhe është nxjerrë numri i publikimeve, numri i citimeve dhe Indeksi i Hirsch.

Në bazë të të dhënave nga Komisioni, Kryesia e Akademisë e ka miratuar njëzëri propozimin e Komisionit dhe ka vendosur që *Shpërblimi mbështetës* i ASHAK-ut për vitin 2025 t'i ndahet **z. Donard Geci**, i lindur më 6 nëntor 1992.

#### Arsyetim:

Dr. sc. Donard Geci, asistent në Departamentin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës i ka 46 publikime të botuara në platformat kryesore të revistave shkencore Web of science dhe Scopus, prej të cilave 16 syresh si autor i parë.

Në platformën Scopus i ka 288 citime dhe e ka indeksin Hirsch 10.

Dr. sc. Donard Geci ka marrë pjesë në 10 konferenca shkencore ndërkombëtare si dhe ka marrë pjesë në disa projekte shkencore ndërkombëtare.

Ceremonia e ndarjes së *Shpërblimit mbështetës* do të mbahet më 25 qershor 2026 në orën 11:00, në mjediset e ASHAK-ut.

